

GJYKATA THEMLORE NË GJILAN, Departamentit i përgjithshëm, Divizioni civil, sipas gjyqtarit, Halil Zahiri, me Ass. Ligjor Baki Sylejmani dhe Vlora Selmani-Rahimi dhe s. juridike, Shefinaze Sahiti, në çështjen juridike të paditësit, J. K., nga Gj., Lagja “...” pa nr. sipas të autorizuarit H. J., nga Gj., kundër të paditurës, P. e K. – K. të b. D., e përfaqësuar prej M. së D., në P., sipas të autorizuarës, N. A., J. nga P., për anulimin e vendimit të Komisionit të brenshëm Disciplinor, në seancën kryesore dhe publike të mbajtur më dt.14.09.2016 bie këtë

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar, kërkesëpadia e J. K., nga Gj., kundër të paditurës, P. e K. – K. të B. D., me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit, Nr. ..., i dt. ..., mbi shqiptimin e ndalesës prej ... të pagës mujore bruto, në kohëzgjatje prej gjasht muaj.

II. Në bazë të nenit 450 të LPK-ës, gjykata vendosi, secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi, J. K., nga Gj., me padi-kërkesëpadi të ushtruar më dt. ... dhe përmirsim të padisë të ushtruar më dt. ..., Gjykatës themlore në Gjilan, i kishte konfirmuar se e paditura, P. e K. – K. i B. D., me vendimin, Nr. ..., i dt. ..., mbi shqiptimin e ndalesës prej ... të pagës mujore bruto, në kohëzgjatje prej gjasht muaj, për shkak se jasht orarit të punës ka intervenuar tek patrulla e policisë gjat kryerjes së detyrës zyrtare gjat tërheqjes së automjetit të një personi familjar i paditësit dhe sjelljeve joprofesionale-etike ndaj njësisë patrulluese.

I autorizuari i paditësit, jur. H. J., nga Gj., në seancën kryesore të mbajtur më dt. ..., kishte deklaruar se mbeteuj pran padisë dhe përmirsimit të padisë, i ka propozuar gjykatës të lexohen të gjitha provat nga lënda, të dëgjohet paditësi në cilësinë e palës dhe dëshmitarët e propozuar dhe pas vërtetimit të gjendjes faktike gjykata të bie aktgjykim me të cilin do ta aprovoi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe anuloi vendimin Nr. ..., i dt. ..., mbi shqiptimin e ndalesës prej ... të pagës mujore bruto, në kohëzgjatje prej gjasht muaj.

E autorizuar e të paditurës, N. A., juriste, në seancën kryesore të mbajtur më dt. ... dhe në përgjigje në padi deklaroi e kundërshtoi në tërësi padinë-kërkesëpadinë e paditësit, e njoftoi gjykatën se paditësi në tërësi është njoftuar me procedurën disiplinore, deklaratat me shkrim e dëshmitarëve, provat nga lënda dhe është këshilluar që të merr një jurist për të ndërmarr veprime dhe këshilla gjat zhvillimit të procedurës disiplinore.

I propozojm gjykatës pas dëgjimit, të paditësit në cilësinë e palës, administrimit të gjitha provave nga lënda dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjykata në pajtim me dispozitat e Ligjit të punës dhe Rregullorës së punës në P. e K., gjykata të bie aktgjykim me të cilin në tërësi do ta refuzoi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Gjykata themelore në Gjilan, i ka dëgjuar paditësin në cilësinë e palës dhe dëshmitarët e propozuar si vijon:

1. Paditësi, J. K., nga Gj., në seancën kryesore të mbajtur më dt. ..., deklaroi është e vërtet që kam intervenuar në patrullën plicore për mos marrjen e automjeti të një familjare

timen dhe ate H. S., nga Gj., e cila e dërgonte babain e sajë te për ti dhënë ndihmën mjekësore dhe është e vërtet se unë ia kam paguar kthimin e Kamionit transportues pasi që i kam ndihmuar që mos ti merret automjeti të njejtës dhe kështu që nuk kam bërë kurrfar shkelje të rregullave të punës për kundër faktit i kam ndihmuar familjaren time pasi që kjo është e drejt e imja. Procedurën e ka inicuar B. L., nga Gj., pronari i kamionit për tërheqje dhe parkut.

Nga të cekurat më lart mendoj se jam i pa fajshëm për veprimet që i kam kryer dhe i propozoi gjykatës që ta anuloi Nr. ..., i dt. ..., mbi shqiptimin e ndalesës prej ... të pagës mujore bruto.

2. Dëshmitari, A. A., nga Gj., në seancën kryesore të mbajtur më dt. ..., deklaroi ne kemi shqyrtuar të gjitha provat e mbledhura, kemi intervistuar kolegët policët, dëshmitarët-punëtorët e autoparkut për tërheqjen e autmjeteve, paditësin dhe nga gjitha këto të dhëna ka rezultuar hetimi i përfunduar se J. K. është shpallur fajtor për shkak të ndërhyrjes së pa autorizuar ndaj patrullës së policisë gjat tërheqjes së mjetit transportues të një familjare të tijë, Komisioni ka marr vendimin me të cilin është shpallur fajtor J. K. dhe iu ka shqiptaur ndalesa prej ... të pagës mujore bruto, në kohëzgjatje prej gjasht muaj.

E njoftoi gjykatën se ndaj pronarit të autoparkut, H. H. ka deklaruar fjal nënqmuese duke i thënë „*kush je ti që më tregon rregulla,*„ „*ulu aty, ti qenke rojtarë,*„ ndërsa B. L., kishte deklaruar se J. K. qa shpesh te kafiteria e tijë na ka penguar duke na detyruar ti fikim dritat e rrotacionit të automjetit tërheqës për vetura, duke pretenduar se i pengojnë, duke i trembur myshterinjët në kafiteri.

E njoftoi gjykatën se J. K. i ka sugjeruar kolegja jon police, L. B., se mos na pengo dhe mos na sjell në pozit të pa lakmueshme ndaj qytetarëve dhe opinionit mos u fjalos me policët, gjith çka ke, mundemi të bisedojm në zyre dhe polici, për kundër sugjerimit të sajë, paditësi fare nuk i ka përfillur këshillat e saja dhe ka vazhduar të fjaloset me policin S. C. etj. Andaj të gjitha veprimet dhe sjelljet e J. K. jan në kundërshtim me rregulloren e punës së P. së K. .

3. Dëshmitari, L. B., nga Gj., në seancën kryesore të mbajtur më dt. ..., deklaroi gjat tërheqjes së autmjeteve nga patrulla policore, unë ia kam tërhequr vërejtjen dhe e kam lutur J. K. që mos të silltet në atë mëyrë ndaj policëve dhe punëtorëve gjat tërheqjes së automjetit, për çdo konsultim dhe kërkesë mundë të bisedojm në zyret e policisë dhe i njejt ka vazhduar të fjaloset me kolegërt - policët dhe nuk e ka përfillur lutjen apo sugjerimin tim që mos të fjaloset me policët dhe punëtorët në pranin e opinionit dhe para qytetarëve, për çka kishte bërë veprim veprime jo profesionale-etike.

E njoftoi gjykatën se ndërhyrjet e J. K. ndaj policëve kan qenë jo profesionale edhe pse nuk është e ndaluar ti ndihmohet antarit të familjes. Deklaroi se J. K. nuk na ka ofenduar, ndërsa na ka thënë „a nuk po keni punë tjera por merreni me tërheqjen e automjeteve nëpër livadhe,„ pra mënyra e sjelljes së tijë ndaj policëve në patrull dhe punëtorëve tjer kan qenë veprime të pa hijëshme dhe për neve kolegve këto fjal kan qenë ofenduese dhe nënqmuese. Procedurën ndaj J. K. e ka inicuar B. L., punëtor gjat tërheqjes së autëmjeve sipas detyrës zyrtare gjat patrullimit.

Në bazë të neneit 8 të LPK-ës, Gjykata i ka lexuar dhe administruar të gjitha provat nga shkresat e lëndës si vijoi:

- Lexohet dhe administrohet, Vendimi nr. ..., i lëshuar më dt. ..., nga komisioni për ankesa dhe shperblime. Nga kjo provë gjykata konstatoi se është rrefuzuar si e pa bazuar

ankesa e ushtruar prej J. K. nga Gj. ndërsa vendimi nr. ..., i lëshuar më dt. ..., nga K. i B. D. vërtetohet dhe mbetet në fuqi.

- Lexohet dhe administrohet, Lënda hetimore nr. ..., prej hetuesit policor, A. A., nga Gj., me shkresat dhe provat sipas titujve si vijon:

- Lexohet dhe administrohet, Zingjiri i ruajtjes së lëndës hetimore prej dt. ... deri më dt. Nga kjo provë gjykata konstatoi ecurin e zhvillimit të procedurës dhe ruajtjes së lëndës hetimore.

- Lexohet dhe administrohet, Lista e shpërndarjes së shkresave, sipas kronologjisë.

- Lexohet dhe administrohet, Vendimi nr. ... i lëshuar më dt. ..., nga komisioni i brendshëm disiplinor. Nga kjo provë gjykata konstatoi se J. K. nga K. i B. D. është shpallur fajtor dhe iu ka shqiptuar ndalesa prej ... të pagës mujore bruto, në kohëzgjatje prej gjashtë muaj.

- Lexohet dhe administrohet, Raporti për komisionin e mbrendshëm disiplinor nr. Nga kjo provë raportohet se J. K., rezultoi të jetë fajtor për veprimet e tija jo profesionale në kundërshtim me rregullat e punës profesionale të policëve të Kosovës.

- Lexohet dhe administrohet, Raporti i përgjithshëm i hetimeve, hyrja, rrëfimi, dosjet e deklaratave dhe përfundimi. Nga kjo provë gjykata konstatoi se rezultoi që J. K., është fajtor për veprimet e tija jo profesionale në kundërshtim me rregullat e punës profesionale të policisë së Kosovës.

- Lexohet dhe administrohet, M. Z. i dt.

- Lexohet dhe administrohet, F. i a. të q. ndaj p. të p. së K. .

- Lexohet, Njoftimi zyrtar i dt. ... me shkresë në gjuhën angleze.

- Lexohet dhe administrohet, V. mbi v. në b. të dh. Në ... për h. të b. e dt.

- Lexohet dhe administrohet, N. i dt. Nga kjo provë rezultoi se J. K., është fajtor për veprimet e tija jo profesionale në kundërshtim me rregullat e punës profesionale të P. së K..

- Lexohet dhe administrohet, R. i o. P. i dt. ..., me pjesën shtese. Nga kjo provë rezultoi se J. K., është fajtor për veprimet e tija jo profesionale në kundërshtim me rregullat e punës profesionale të P. së K. .

- Lexohen dhe administrohen, deklaratat e dt. ..., nga B. S. dhe H. H., nga Gj..

- Lexohet dhe administrohet, Procesverbali për intervistën e ankuesit në lëndën hetimore të dt.

- Lexohet dhe administrohet, Procesverbali mbi intervistën e dëshmitarit në lëndën hetimore të dt.

- Lexohet dhe administrohet, Procesverbali mbi intervistën e dëshmitarit H. H. e dt.

- Lexohet dhe administrohet, Procesverbali mbi intervistën e dëshmitarit N. A. i dt.

- Lexohet dhe administrohet, Procesverbali mbi intervistën e dëshmitarit S. C. e dt.

Nga kjo provë rezultoi se J. K., është fajtor për veprimet e tija jo profesionale në kundërshtim me rregullat e punës profesionale të P. së K. .

- Lexohet dhe administrohet, Procesverbali mbi intervistën e dëshmitarit B. S., e dt.

- Lexohet dhe administrohet, Procesverbali mbi intervistën e J. K. e dt. Nga kjo provë rezultoi se J. K., është fajtor për veprimet e tija jo profesionale në kundërshtim me rregullat e punës profesionale të P. së K. .

- Lexohet dhe administrohet, Procesverbali mbi intervistën e dëshmitarit R. T. i dt. Nga kjo provë rezultoi se J. K., është fajtor për veprimet e tija jo profesionale në kundërshtim me rregullat e punës profesionale të P. së K. .

- Lexohet dhe administrohet, Procesverbali mbi intervistën e dëshmitarit B. L. i dt.

- Lexohet dhe administrohet, Procesverbali mbi intervistën e dytë të dëshmitarit S. C. i dt. Nga kjo provë rezultoi se J. K., është fajtor për veprimet e tija joprofesionale në kundërshtim me rregullat e punës profesionale të P. së K. .

- Lexohet dhe administrohet, Suspendimi për J. K. i lëshuar më dt.

- Lexohet dhe administrohet, Shkresa me titull Obligimi dhe të drejtat e punonjësit.

- Lexohet dhe administrohet, urdhëresa mbi ekzekutimin e vendimit sipas nr. ..., të dt.

...

- Lexohet dhe administrohet, Urdhëresa për ekzekutim e dt.

- Lexohet dhe administrohet, Ndërrerja e suspendimit të përkohëshme e dt.

- Lexohet dhe administrohet, Urdhëresa e dt. ... për ekzekutim e vendimit.

- Lexohet dhe administrohet, Shkresa në gjuhën A. S. order e dt. ..., me 4 rreshta të bashkangjitura në gjuhën angleze.

- Lexohet dhe administrohet, R. nga D. e H. për formën e nënshkrimit të prezencës në punë. Nga kjo provë rezulton se J. K., është fajtor për veprimet e tija jo profesionale në kundërshtim me rregullat e punës profesionale të P. së K. .

- Lexohet dhe administrohet, procesverbali mbi intervistën e ankuesit në lëndën hetimore nr. ... e dt. ... nga ora

- Shiqohen dhe administrohet, kopjet e letërnjoftimeve për dëshmitarët - policët, L. B. dhe A. A., nga Gj.

Në fjalën përfundimtare, i autorozuari paditësi jurist H. J. deklaroi në afat prej 8 ditësh do ta dërgoi fjalën përfundimtare, ndërsa i njëjti për shkak të neglizhencës dhe joazhuritësi fjalën përfundimtare e ka dorëzuar në gjykatë pas 3 javëve me çka e ka vonuar gjyqtarin e çështjes ta përpiloi aktgjykimin.

E autorizuar e të paditës deklaroi se mbetet pran përgjigjes në padi dhe i propozoi gjykatës ta refuzoi në tërësi padinë si të pa bazuar.

Pas administrimit të gjitha provave në hollësi veç e veç në relacioni krahasues duke i analizuar të gjitha provat, thënjet e palëve ndërgjyqëse dhe deklaratave me shkrim të dëshmitarëve, gjykata e konstatoi gjendjen faktike si vijoi:

- Se e paditura në tërësi e ka zbatuar procedurën disiplinore ndaj të dyshuarit J. K. dhe e ka shpallur fajtor, për shkak se paditësi me veprimet e tija nuk ka kryer punën e tijë profesionale dhe ndaj patrullës policore-policëve dhe punëtorëve në autoparkun për tërheqjen e automjeteve është sjellur në mënyrë jo profesionale dhe të pahijshme dhe për këtë Komisioni i brendshëm disiplinor me vendimin e sajë e ka shpallur paditësin fajtor dhe ia ka shqiptuar ndalesën prej ... të pagës mujore bruto, në kohëzgjatje prej gjashtë muaj.

- Se Komisioni për ankesa dhe shpërblyme si organi shkallës së dytë ia ka refuzuar ankesën e paditësit të ushtruar kundër vendimit të shkallës së parë dhe të njëjtin vendim e ka vërtetuar duke lënë në fuqi.

- Gjykata konstatoi se paditësi me as një provë nuk ka mundur ta vërtetoi kërkespadinë si të bazuar dhe në mungesë të provave, e ka refuzuar kërkespadinë e paditësit në tërësi si të pabazuar, ndërsa vendimet e të paditurës i konsideroi si të ligjshme, të bazuara dhe në përputhje me standardet dhe kornizën ligjore të Kosovës.

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për policinë e Kosovës, në bazë të kreut III, neni 14 pika 1.7, dhe 1.14 të Udhëzimit administrativ nr.06/2012-DPP, për shkeljet, masat dhe procedurën disiplinore në P. e K. dhe Neni 143 të LPK-ës, gjykata e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe konstatoi se e tërë procedura disiplinore është zbatuar në pajtim me Ligjet dhe aktet nënligjore, për çka gjykata e ka refuzuar kërkespadinë e paditësit si të pa bazuar dhe vendosi si në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

Gjykata në bazë të nenit 450 të LPK-ës, vendosi që sejcila palë ti bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Gjyqtari
Mr.sc.Halil Zahiri

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit, në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftuara për mes kësaj gjykate.